VENDIM
Nr. 294, datë 13.11.2025

MBI MIRATIMIN E UDHËZIMIT "PËR MËNYRËN E PASQYRIMIT TË KONSUMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NË FATURËN MUJORE DHE IDENTIFIKIMIN E NDARË TË KATEGORIVE TË KONSUMATORËVE DHE ZBATIMIN E ÇMIMEVE PËRKATËSE"

Në mbështetje të neneve 16 dhe 81 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "c", të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe PROCEDURAT e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.11.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Çështjeve Konsumatori, Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve dhe Sekretari i Përgjithshëm me nr. 2818 prot., datë 10.11.2025, "Mbi miratimin e udhëzimit 'Për mënyrën e pasqyrimit të konsumit të energjisë elektrike në faturën mujore dhe identifikimin e ndarë të kategorive të konsumatorëve dhe zbatimin e çmimeve përkatëse'";

konstatoi se:

- ERE në ushtrim të kompetencave të tij ligjore të përcaktuara ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, është përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike, me qëllim sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm, mbrojtjen e konsumatorëve dhe garantimin e transparencës dhe efikasitetit në tregun e furnizimit.
- ERE ka kompetencën për të miratuar metodologjitë e tarifimit, tarifat dhe çmimet e furnizimit publik me pakicë, për kategori të ndryshme konsumatorësh, si dhe për të përcaktuar rregullat e faturimit dhe detyrimet e furnizuesve ndaj konsumatorëve fundorë.
- Në zbatim të kësaj kompetence, ERE ka miratuar vendime të veçanta për miratimin e tarifave të furnizimit publik me energji elektrike për kategoritë e mëposhtme të konsumatorëve, të cilat janë në fuqi dhe zbatohen nga furnizuesit publikë:
- Familjar;
- Familjar me konsum nën 700 kwh;
- Jofamiljar;
- Objekte kulti;
- Furra buke/prodhim mielli;
- Pika/stacione karikimi automjetesh elektrike (EV);
- Ujësjellës-kanalizime të lidhura në nivelin e tensionit 35 kV/20 kV/10 kV/6 kV.
- ERE vlerëson të nevojshëm hartimin e një udhëzimi për të përcaktuar modalitetet e pasqyrimit në fatura mujore të konsumit të energjisë elektrike dhe çmimit të miratuar të aplikueshëm, në varësi të kategorisë së cilës i përket konsumatori.
- Aktualisht, rezulton se FSHU sh.a., në cilësinë e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, nuk evidenton në emërtesë apo të dhënat e faturës kategorinë e konsumatorit ndaj të cilit ofron shërbimin si FSHU, apo si FMF.
- Në faturat e lëshuara nga Furnizuesit për kategorinë e konsumatorëve vetëpordhues nuk evidentohet kategoria së cilës konsumatori i përket, si dhe ndarja mes sasisë së energjisë së prodhuar nga konsumatori vetëprodhues dhe sasisë së energjisë së marrë nga vetëprodhuesi prej furnizuesit që i ofron shërbimin e furnizimit.
- Faturimi për konsumatorët që i përkasin kategorisë furrë buke/prodhim mielli, nuk evidenton në të dhënat e faturës kategorinë apo nënkategorinë së cilës i përket konsumatori për të cilin

lëshohet fatura e konsumit të energjisë sipas nënkategorive: kategoria I – vetëm furra buke/prodhim mielli; kategoria II – furrë buke, produkte mielli shoqëruese, pastiçeri; kategoria III – furrë buke, produkte mielli shoqëruese, pastiçeri, shërbim kafe (ekspres) parashikon aplikimin e çmimeve të ndryshme.

- Me qëllim pasqyrimin e saktë e të drejtë të kategorisë së cilës i përket konsumatori, i cili përfiton çmimin sipas nënkategorive të miratuara nga ERE, në këtë udhëzim të parashikohen detyrime për reflektimin e të dhënave të detajuara të kategorisë së konsumatorit, në informacionin e përcjellë në faturën e konsumit të energjisë elektrike apo së bashku me faturën.

- Mbështetur në parimet e nenit 81, të ligjit nr. 43/2015, konsumatori, së bashku me faturën e energjisë, ka të drejtë të informohet në mënyrë të qartë dhe të plotë për çmimet, tarifat, kushtet e furnizimit dhe elementet që përbëjnë faturën mujore të energjisë elektrike.

- Po ashtu, mbështetur në neni 11 i Kushteve të Përgjithshme të Kontratës së Furnizimit të Energjinë Elektrike përcakton se furnizuesi është i detyruar të përfshijë në faturë, të dhënat identifikuese të konsumatorit dhe pikës së lidhjes, periudhën e faturimit, sasinë e konsumuar të energjisë elektrike, çmimin për njësi sipas strukturës së tarifës së miratuar nga ERE, dhe çdo informacion tjetër që lidhet me kostot e shërbimit të furnizimit.

- Zbatimi i këtij udhëzimi do të mundësojë kontrollin efektiv të zbatimit të tarifave të miratuara, do të shmangë abuzimet e mundshme në klasifikimin e konsumit dhe do të garantojë një nivel të lartë transparence, në përputhje me detyrimet ligjore dhe standardet e mbrojtjes së konsumatorit në sektorin e energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e "Udhëzimit për mënyrën e pasqyrimit të konsumit të energjisë elektrike në faturën mujore, identifikimin e ndarë të kategorive të konsumatorëve dhe zbatimin e çmimeve përkatëse" (bashkëlidhur).

2. Ngarkohet Drejtoria e Çështjeve Konsumatore të njoftojë palët e interesit dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe aplikohet për faturimet që kryhen, duke filluar nga muaji dhjetor 2025.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

UDHËZIM
PËR MËNYRËN E PASQYRIMIT TË KONSUMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NË FATURËN MUJORE, IDENTIFIKIMIN E NDARË TË KATEGORIVE TË KONSUMATORËVE DHE ZBATIMIN E ÇMIMEVE PËRKATËSE

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim përcaktimin e mënyrës së detajuar të pasqyrimit të konsumit të energjisë elektrike në faturat mujore të furnizimit, me qëllim sigurimin e transparencës, ndarjen e qartë të konsumit sipas kategorive së konsumatorëve dhe garantimin e aplikimit të drejtë të tarifave dhe çmimeve përkatëse për çdo kategori konsumatori.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Ky udhëzim zbatohet nga furnizuesi publik i energjisë elektrike, furnizuesit e tregut të lirë për kategoritë përkatëse të konsumatorëve ndaj të cilëve ofrojnë shërbim dhe operatorin e sistemit të shpërndarjes (OSSH), si dhe për të gjithë konsumatorët fundorë, që kanë lidhur kontrata furnizimi për kategori të ndryshme konsumatore të përcaktuara nga ERE.
2. Dispozitat e këtij udhëzimi janë të detyrueshme për subjektet që realizojnë faturimin, matjen dhe raportimin e konsumit të energjisë elektrike ndaj konsumatorëve.

Neni 3
Ndarja e konsumit në faturë sipas kategorive tarifore

1. Konsum familjar/jofamiljar:

a) Konsumi për nevoja familjare duhet të pasqyrohet në faturë në mënyrë të qartë dhe të veçantë, me aplikimin e çmimit të miratuar nga ERE.

b) Rubrika përkatëse në faturë duhet të mbajë titullin "Konsum familjar" dhe të shoqërohet me matësin përkatës.

2. Konsum për karikimin e automjeteve elektrike (EV):

a) Në rastet kur konsumatori ka të instaluar një pikë/stacion karikimi të makinave elektrike me fuqi të instaluar mbi 11 kw dhe është i lidhur në nivelin e tensionit 04 kV, energjia e përdorur për karikimin e automjetit elektrik duhet të matet përmes një njësie matëse të pavarur.

b) Konsumi për karikimin e automjetit elektrik duhet të pasqyrohet në faturë të veçantë me titullin "Konsum për karikim automjeti elektrik (EV)", me aplikimin e çmimit përkatës të miratuar nga ERE.

c) Furnizuesi duhet të specifikojë në faturë-fuqinë përkatëse të instaluar në kw për kategorinë e konsumatori mbi 11 kw.

3. Konsumatorë vetëprodhues:

a) Për konsumatorët që prodhojnë energji elektrike nga burime të rinovueshme (panele fotovoltaike etj.), fatura mujore duhet të përmbajë dy rubrika të ndara:

- "Energjia e prodhuar nga vetë konsumatori (kwh)";
- "Energjia e marrë nga rrjeti (kwh)".

b) Faturimi neto ndërmjet energjisë së prodhuar dhe asaj të marrë nga rrjeti llogaritet dhe reflektohet në faturë, sipas metodologjisë së miratuar nga Këshilli i Ministrave.

c) Furnizuesi është i detyruar të garantojë pasqyrimin e qartë dhe të lexueshëm të të dhënave të vetëprodhimit në faturën mujore.

Neni 4

Identifikimi i kategorisë së konsumatorit në faturë

1. Çdo faturë mujore duhet të përmbajë seksionin "Kategoria e konsumatorit sipas kontratës", ku të shënohet qartë kategoria përkatëse.

2. Kategoritë që duhet të identifikohen në faturë janë:

- Familjar;
- Të tjerë të lidhur në 0.4 të furnizuar nga Furnizuesi Universal;
- Familjar me konsum nën 700 kw
- Konsumator i FMF-së;
- Objekt kulti;
- Furra buke/prodhim mielli (sipas nënkategorive);
- Pika/stacione karikimi automjetesh elektrike (EV);
- Vetëprodhues (me burime të rinovueshme të energjisë);
- Ujësjellës-kanalizime të lidhura në nivelin e tensionit 35 kV/20/10/6 kV.
- Të tjera, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

3. Mosidentifikimi i kategorisë përbën shkelje të detyrimeve të faturimit dhe u nënshtrohet masave administrative sipas vendimeve të ERE-s.

Neni 5

Detyrimet e furnizuesve dhe operatorëve të rrjetit

1. Furnizuesit e energjisë elektrike janë të detyruar të:

- përditësojnë sistemet e faturimit elektronik për të mundësuar pasqyrimin dhe faturimin e konsumit sipas kategorive të konsumatorëve;
- raportojnë çdo tre muaj pranë ERE-s listën e kontratave të konsumatorëve që disponojnë pajisje karikimi për automjete elektrike dhe/ose kapacitete vetëprodhimi.

2. Operatori i sistemit të shpërndarjes (OSSH) ose Operatori i Transmetimit ka detyrimin të:

- verifikojë instalimet matëse për konsumet e ndara;
- sigurojnë që matjet të jenë të sakta, të certifikuara dhe të azhurnuara sipas standardeve metrologjike në fuqi.
- raportojnë çdo tre muaj pranë ERE mbi sasinë e energjisë së shpërndarë për çdo kategori të përcaktuar në nenin 4 pika 2, fuqinë e instaluar/ngarkesë për çdo pikë, si dhe shpërndarjen gjeografike të çdo pike.

Neni 6

Zbatimi dhe kontrolli

1. Zbatimi i këtij udhëzimi është detyrë e furnizuesve dhe operatorëve të sistemit të shpërndarjes.

2. Kontrolli i zbatimit kryhet nga ERE dhe njoftohet rregullisht Agjencia për Eficiencën e Energjisë (AEE) për gjetjet.

3. Në rastet e shkeljeve të përcaktuara në këtë udhëzim, ERE do të marrë masa administrative në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 7

Të tjera

1. Për konsumatorët ekzistues, të cilët kanë një pikë/stacion karikimi me fuqi të instaluar mbi 11 kw, të lidhur në nivelin e tensionit 0,4 kV, të cilët kanë një pikë lidhjeje të miratuar, por nuk kanë një kontratë furnizimi, Furnizuesi i Shërbimit Universal duhet të gjenerojë një kontratë të re furnizimi. Konsumatorët ekzistues nuk ngarkohen me kosto shtesë për instalimin e një sistemi matjeje për këto pika/stacione karikimi.

2. Të gjithë konsumatorët që aplikojnë për herë të parë për një pikë/stacion karikimi me fuqi të instaluar mbi 11 kw të lidhur në nivelin e tensionit 0,4 kV, duhet të lidhin kontratë të re me furnizuesin, i cili ofron këtë shërbim.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas miratimit nga Bordi i Komisionerëve të ERE-s.